

Selcom Sh.p.k

Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

PËRMBAJTJA:

	FAQE
PASQYRAT FINANCIARE:	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	2
PASQYRA E PERFORMANCËS	3
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	4
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	5
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	6 - 21

**Pasqyra e Pozicionit Financiar
më 31 dhjetor 2016**

	Shënime	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	4	2,339,055	2,684,162
Llogari të arkëtueshme tregtare	5	14,664,916	13,649,586
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	6	6,771,449	5,185,426
Të tjera llogari të arkëtueshme	7	4,082,152	4,185,435
Inventari	8	4,641,150	3,600,087
Shpenzime të shtyra	9	1,546,998	498,768
Të arkëtueshme nga të ardhura të konstatuara	10	6,058,821	4,027,463
Total Aktive Afatshkurtra		40,104,541	33,830,927
Aktivët afatgjatë			
Aktive afatgjatë materiale	11	34,255,264	33,081,833
Aktive afatgjatë jomateriale	12	43,750	50,272
Total aktive afatgjatë		34,299,014	33,132,105
Total Aktive		74,403,555	66,963,032
DETYRIMET			
Detyrime afatshkurtra			
Hua afatshkurtra	13	2,625,385	6,671,669
Llogari të pagueshme tregtare	14	3,737,508	2,227,811
Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura	15	2,942,746	3,189,673
Të pagueshme për shpenzime të konstatuara	16	1,524,240	2,635,139
Detyrime tatimore	17	2,354,747	1,717,297
Të ardhurat e shtyra	18	60,200	60,200
Të tjera detyrime	19	3,012,768	2,674,250
Total Detyrime afatshkurtra		16,257,594	19,176,039
Detyrime afatgjatë			
Hua afatgjatë	20	4,217,033	7,456,190
Llogari të pagueshme nga palët e lidhura	21	15,208,044	22,612,667
Total Detyrime afatgjatë		19,425,077	30,068,857
Totali i detyrimeve		35,682,671	49,244,896
Kapitali aksionar	22		
Kapitali i nënshkruar		100,000	100,000
Rezerva ligjore		10,000	10,000
Rezerva të tjera		17,608,136	6,441,654
Fitimi i ushtrimit		21,002,748	11,166,482
Total kapitali aksionar		38,720,884	17,718,136
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		74,403,555	66,963,032

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 21, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyra e Performancës**Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016**

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	23	94,440,685	61,454,546
Puna e kryer nga njësia ekonomike e kapitalizuar		2,553,825	3,548,000
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	24	(335,264)	6,555
Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme		(58,860,432)	(40,595,132)
Lënda e parë dhe materiale të			
1) konsumueshme	25	(52,575,792)	(35,339,916)
2) Të tjera shpenzime	26	(6,284,640)	(5,255,216)
Shpenzime të personelit	27	(8,881,603)	(6,722,039)
1) Paga dhe shpërblime		(7,687,846)	(5,836,891)
Shpenzime të sigurimeve			
2) shoqërore/shëndetsore		(1,193,757)	(885,148)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	11/12	(3,612,927)	(3,660,676)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	28	(6,149)	103,166
Të ardhura të tjera		-	-
Shpenzime financiare	29	(478,747)	(851,356)
Shpenzime interesi dhe shpenzime të			
1) ngjashme		(815,580)	(1,060,297)
2) Shpenzime të tjera financiare		336,833	208,941
Fitimi/humbja para tatimit		24,819,388	13,283,064
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	30	(3,816,640)	(2,116,582)
1) Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin		(3,816,640)	(2,116,582)
Fitimi/humbja e vitit		21,002,748	11,166,482
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin:		-	-
Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin		21,002,748	11,166,482

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 21, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Selcom Sh.p.k

(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e ndryshimeve në Kapital
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

	Kapitali i nënshkruar	Rezerva Ligjore	Rezerva të tjera	Humbje te mbartura	Fitim / Humbja e vitit	Totali
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2014	100,000	10,000	-	(376,512)	6,818,166	6,551,654
Fitimi / Humbja e vitit					11,166,482	11,166,482
Lëvizjet përmes kapitalit			6,441,654	376,512	(6,818,166)	-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2015	100,000	10,000	6,441,654	-	11,166,482	17,718,136
Fitimi / Humbja e vitit					21,002,748	21,002,748
Lëvizjet përmes kapitalit			11,166,482		(11,166,482)	-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2016	100,000	10,000	17,608,136	-	21,002,748	38,720,884

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 21, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016 u aprovuan dhe u nënshkruan si më poshtë:

Altin Bushka

Altin Bushka
Administrator



Mazars Shpk

Mazars shpk
Hartues i Pasqyrave



**Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016**

Shenime	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015
Flukset e parasë nga aktivitetet operative		
Fitim / Humbja e vitit	21,002,748	11,166,482
Rregullimet për shpenzimet jomonetare:		
Diferenca këmbimi jo nga aktivitete operative	(62,472)	(191,465)
Shpenzimet për tatimin mbi fitimin jomonetar	2,069,722	1,099,873
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	3,612,927	3,660,676
Rezultati nga shitja e aseteve	(13,503)	(56,718)
Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	(5,577,658)	(1,788,937)
Rënie/(rritje) në inventarë	(1,041,063)	(3,464,624)
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme	(732,523)	(954,114)
Rritje/(rënie) në detyrime për punonjësit	3,516	20,770
Mjete monetare neto nga aktiviteti i shfrytëzimit	19,261,694	9,491,943
Fluksi i Mjeteve Monetare nga aktiviteti i investimit		
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale	(4,791,722)	(6,264,932)
Arkëtime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale	25,389	130,380
Mjete monetare neto nga aktiviteti i investimit	(4,766,333)	(6,134,552)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga aktiviteti i financimit		
Pagesa e huave	(14,566,104)	(3,163,750)
Mjete monetare neto nga aktiviteti i financimit	(14,566,104)	(3,163,750)
Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare	(70,743)	193,641
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar	2,684,162	2,507,997
<i>Efekti i luhatjeve të kursit të këmbimit të mjeteve monetare</i>	(274,364)	(17,476)
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor	2,339,055	2,684,162
4		

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 21, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. Informacion i përgjithshëm

“Selcom” sh.p.k (Kompania) është themeluar si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar më 18 Korrik 2006 në përputhje me Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

Kapitali i nënshkruar i shoqërisë është 100,000 Lekë, i ndarë në 100 njësi të barabarta me nga 1,000 Lekë secila.

Ortakët e shoqërisë janë :

- Z. Gentian Sula zotërues i 65 kuotave ose 65% të kapitalit të shoqërisë;
- Z. Altin Bushka zotërues i 35 kuotave ose 35% të kapitalit të shoqërisë;

Aktiviteti kryesor i kësaj shoqërie është ofrimi i shërbimeve të telefonisë, internetit. Projektim dhe zbatim i rrjeteve dhe sistemeve telefonike, rrjeteve dhe sistemeve kompjuterike, sistemeve të vëzhgimit me kamera IP dhe me qark të mbyllur. Import, eksport dhe tregtim me shumicë dhe pakicë të pajisjeve elektronike.

Adresa e selisë së shoqërisë është: Selitë, Tiranë.

Më 31 dhjetor 2016 Shoqëria kishte 15 punonjës (2015: 14 punonjës).

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK) dhe ligjin nr.9228, datë 29 prill 2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe amenduar me urdhrin nr.64 datë 22.7.2014 “Për shpalljen e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre duke filluar nga 1 janar 2015.

Ky urdhër hyri në fuqi në fletoren zyrtare nr.119 datë 1 gusht 2014.

Kompania përdor formatin e publikuar nga NAS për prezantimin e pasqyrave financiare.

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale.

2. Bazat e pregatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)**2.5 Vlerësime dhe gjykime (vazhdim)**

Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga paaftësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çrregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50% , në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit që mund të masë me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	2016	2015
Euro/ALL	135.23	137.28
USD/ ALL	128.17	125.79

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbje, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivët financiarë çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiarë (vazhdim)

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivitet financiar të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivitet të tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivitet financiar të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.3. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

3.4. Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivitet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitet. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitet në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe koston e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivitet. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitet kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivitet afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

i. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)**3.4. Aktive afatgjata materiale (vazhdim)***iii. Amortizimi*

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2016 dhe 2015 është si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Mobilje dhe orëndi	Vlerë e mbetur	20 %
Pajisje informatike	Vlerë e mbetur	25 %
Ndërtime dhe instalime	Vlerë e mbetur	5%
Makineri dhe pajisje	Vlerë e mbetur	20 %
Automjete	Vlerë e mbetur	20%
Të tjera	Vlerë e mbetur	20 %

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

a. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundur që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

b. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

c. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)**d. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare**

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

e. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2016 është 15% (2015: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshem (apo të rikuperueshem) në periudhat e ardhshme, i cili përlllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivitet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundur që fitimi i tatueshem në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

f. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

g. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

h. Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)**i. Aktivet dhe Detyrimet e Kushtëzuara**

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

4. Mjete monetare

Mjetet monetare në arkë dhe bankë detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
Mjete monetare në bankë	1,240,940	2,590,726
Llogari rrjedhëse	1,240,940	2,590,726
Mjete monetare në arkë	1,098,115	93,436
	2,339,055	2,684,162

5. Llogari të arkëtueshme tregtare

Llogaritë e arkëtueshme tregtare më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
Klientë	14,664,916	13,649,586
	14,664,916	13,649,586

6. Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura

Të arkëtueshmet ndaj palëve të lidhura më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
Të tjera të arkëtueshme nga BPO	331,653	106,333
Të arkëtueshme tregtare nga palët e lidhura	6,439,796	5,079,093
	6,771,449	5,185,426

7. Të tjera llogari të arkëtueshme

Llogaritë të tjera të arkëtueshme më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
Debitorë kreditorë të tjerë	4,082,152	4,185,435
	4,082,152	4,185,435

8. Inventari

Gjendja e inventarit më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 është si më poshtë:

	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
Lëndë e parë dhe materiale	4,225,662	3,342,560
Mallra për rishitje	415,488	257,527
	4,641,150	3,600,087

9. Shpenzime të shtyra

Shpenzimet e shtyra detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
Shpenzime të periudhave të ardhshme	359,984	136,373
Parapagime për furnitorët	1,187,014	362,395
	1,546,998	498,768

10. Të arkëtueshme nga të ardhura të konstatuara

Të arkëtueshmet nga të ardhurat e konstatuara detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
Të ardhura të llogaritura nga telefonia	6,058,821	4,027,463
	6,058,821	4,027,463

Selcom Shpk
Shënime e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(Vlerat janë në Lek)

11. Aktive Afatgjata Materiale

	Makineri Pajisje	Automjetet	Mobilje orendi	Paisje kompjuterike	Instrumenta dhe vegla pune	Ne proces	Nderime dhe instalime	Te tjera	Totali
Kosto									
Gjendja më 31 Dhjetor 2014	21,463,114	478,244	199,730	2,212,936	62,378	12,087,846	7,752,949	541,952	44,799,149
Shtesa	1,635,561	684,744	53,468	205,417			15,635,846	117,598	18,332,634
Pakësime	(21,626)			(70,000)		(12,087,846)			(12,179,472)
Gjëndja më 31 Dhjetor 2015	23,077,049	1,162,988	253,198	2,348,353	62,378	-	23,388,795	659,550	50,952,311
Shtesa	1,111,169	380,000		109,907	78,000		2,884,105	228,541	4,791,722
Pakësime	(7,455)			(8,750.0)					(16,205)
Gjëndja më 31 Dhjetor 2016	24,180,763	1,542,988	253,198	2,449,510	140,378	-	26,272,900	888,091	55,727,828
Amortizimi i akumuluar									
Gjendja më 31 Dhjetor 2014	10,962,401	105,081	169,752	644,622	34,777	-	2,235,101	81,042	14,232,776
Amortizimi i vitit	2,172,373	110,079	27,039	336,182	4,132		890,597	115,263	3,655,665
Pakësime	(12,130)			(5,833)					(17,963)
Gjëndja më 31 Dhjetor 2015	13,122,644	215,160	196,791	974,971	38,909	-	3,125,698	196,305	17,870,478
Amortizimi i vitit	1,915,110	202,232	9,168	267,581	15,505		1,082,090	114,719	3,606,405
Riklasifikime									-
Pakësime	(1,209)							(3,110)	(4,319)
Gjëndja më 31 Dhjetor 2016	15,036,545	417,392	205,959	1,242,552	54,414	-	4,207,788	307,914	21,472,564
Vlera neto kontabël									
Gjendja më 31 Dhjetor 2014	10,500,713	373,163	29,978	1,568,314	27,601	12,087,846	5,517,848	460,910	30,566,373
Gjendja më 31 Dhjetor 2015	9,954,405	947,828	56,407	1,373,382	23,469	-	20,263,097	463,245	33,081,833
Gjendja më 31 Dhjetor 2016	9,144,218	1,125,596	47,239	1,206,958	85,964	-	22,065,112	580,177	34,255,264

Selcom Shpk
Shënime e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(Vlerat janë në Lek)

12. Aktive Afatgjata Jo Materiale

	AAJM	Total
Me kosto		
Gjendja me 31 Dhjetor 2015	87,476	87,476
Shtesa	-	-
Pakesime	-	-
Gjendja me 31 Dhjetor 2016	87,476	87,476
Amortizimi		
Gjendja me 31 Dhjetor 2015	37,204	37,204
Amortizimi i vitit	6,522	6,522
Kthim amortizimi	-	-
Gjendja me 31 Dhjetor 2016	43,726	43,726
		-
Gjendja Neto me 31 Dhjetor 2015	50,272	50,272
Gjendja Neto me 31 Dhjetor 2016	43,750	43,750

13. Huat aftashkurta

Në këtë zë është paraqitur overdrafti nga bankat më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
Overdraft ICB	2,625,385	6,671,669
	2,625,385	6,671,669

14. Llogari të pagueshme tregtare

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
Furnitorë vendas	3,679,479	2,209,255
Furnitorë të huaj	58,029	18,556
	3,737,508	2,227,811

15. Të pagueshme ndaj palëve të lidhura

Të pagueshmet ndaj palëve të lidhura më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
Të pagueshme të tjera ndaj palëve të lidhura	2,409,990	2,444,041
Të pagueshme tregtare nga palët e lidhura	532,756	745,632
	2,942,746	3,189,673

Selcom Shpk
Shënime e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(Vlerat janë në Lek)

16. Të pagueshme për shpenzime të konstatuara

Të pagueshmet për shpenzime të konstatuara më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
Shpenzime të konstatuara për telefoninë	1,476,006	2,635,139
Shpenzime të tjera të konstatuara	48,234	
	1,524,240	2,635,139

17. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 detajohen si më poshtë:

	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
Tatim fitimi	2,069,722	1,099,873
Kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	176,370	166,685
TVSH për t'u paguar	64,334	409,157
Tatimi mbi të Ardhurat nga Punësimi	42,224	41,582
Detyrime doganore	2,097	
	2,354,747	1,717,297

18. Të ardhura të shtyra

Të ardhurat e shtyra detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
Parapagim nga klient	60,200	60,200
	60,200	60,200

19. Të tjera detyrime

Detyrimet e tjera për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 detajohen si më poshtë:

	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
Paga për t'u paguar	2,481,899	2,478,384
Debitorë & kreditorë të tjerë për modema	530,869	195,866
	3,012,768	2,674,250

20. Hua afatgjata

Huatë afatgjata detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
Kredi ICB	4,217,033	7,456,190
	4,217,033	7,456,190

21. Të pagueshme afatgjata ndaj palëve të lidhura

Të pagueshmet ndaj palëve të lidhura më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
Të pagueshme të tjera ndaj ortakëve	15,208,044	22,612,667
	15,208,044	22,612,667

22. Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është në vlerë 100, 000 Lekë. Gjate vitit 2016 nuk ka pasur ndryshim në strukturën e kapitalit të shoqërisë.

23. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Të ardhura nga telefonia	78,668,483	50,843,926
Të ardhura nga interneti	15,772,202	10,350,062
Të ardhura nga shitja e mallrave dhe shërbimeve		260,558
	94,440,685	61,454,546

24. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit përfshijnë fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit nga aktiviteti tregtar dhe detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Fitime nga këmbimet valutore nga aktiviteti i shfrytëzimit	183,683	198,738
Humbje nga këmbimet valutore nga aktiviteti i shfrytëzimit	(532,450)	(248,901)
Të ardhura nga shitja e aktiveve afatgjata	25,389	130,380
Vlera neto kontabël e aseteve të shitura	(11,886)	(73,662)
	(335,264)	6,555

Rakordimi i të ardhurave me deklaratat e TVSH-së dhe Tatim Fitimit.

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Rakordimi i të ardhurave me FDP-në	
Shitje total të deklaruara në FDP TVSH	95,323,659
Garanci për modema	(335,118)
Anullim i të ardhurave të 2015 deklaruar në 2016	(4,027,463)
Përllogaritje e të ardhurave të 2016 deklaruar në 2017	6,058,821
Shitje të deklaruar në FDP që janë të ardhura në PASH	97,019,899
Të ardhura telefoni/internet	94,440,685
Shitje AQT	25,389
Të ardhura nga prodhimi i AQT-së	2,553,825
Të ardhura të deklaruara në PASH të cilat janë deklaruar shitje në FDP	97,019,899
Të ardhurat nga interesat	136
Fitim nga këmbimet valutore	596,412
Total të ardhura të deklaruara FDP e Tatim Fitimit	97,616,447

25. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme

Në këtë zë paraqiten kostoja e mallrave, lëndëve të para dhe shërbimeve të konsumuara që lidhen më veprimtarinë e shfrytëzimit. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Nënkotraktorë	47,879,583	29,517,488
Kosto e materialeve	3,146,869	3,335,505
Materiale të tjera ndihmëse	1,491,340	2,099,923
Mirëmbajtje centrali	58,000	387,000
	52,575,792	35,339,916

26. Të tjera shpenzime

Shpenzimet e tjera detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Shpenzime qeraje	1,669,518	1,703,851
Konsulence ekonomike	1,200,000	-
Taksa dhe tarifa të ndryshme	804,953	777,488
Shpenzime transporti	643,135	244,745
Shpenzime të ndryshme dhe të panjohura	618,727	603,961
Komisione bankare	474,204	704,095
Mirëmbajtje dhe riparime	334,211	773,062
Shpenzime administrative	262,173	66,472
Shpenzime postare dhe telekomunikacioni	102,883	96,896
Blerje të ndryshme, kancelari etj	99,183	91,308
Siguracione makina	39,053	15,500
Shpenzime për pritje	36,600	87,208
Shërbime nga të tretë	-	14,045
Shpenzime udhëtimi dhe dieta	-	9,000
Dhurata	-	67,585
	6,284,640	5,255,216

27. Shpenzime të personelit

Shpenzimet e personelit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Shpenzime për paga	7,687,846	5,836,891
Shpenzime për sigurime shoq. e shëndetësore	1,193,757	885,148
	8,881,603	6,722,039

28. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit

Shpenzimet e tjera të shfrytëzimit paraqesin gjokat dhe penalitetet për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
Gjoka dhe penalitete	6,149	(103,166)
	6,149	(103,166)

29. Shpenzime financiare

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit dhe rezultatin nga kursi i këmbimit që lidhet me aktivitetin financiar të shoqërise. Ky zë detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Shpenzime për interesa	(815,719)	(1,091,409)
Të ardhura nga interesat	136	19,802
Te ardhura te tjera financiare		11,310
Humbje nga këmbimet valutore	(75,893)	-
Të ardhura nga këmbimet valutore	412,729	208,941
	(478,747)	(851,356)

30. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Përllogaritja e shpenzimit për tatimin mbi fitimin paraqitet më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Fitimi para tatimit	24,819,388	13,283,064
Shpenzime të panjohura të tjera (si më poshtë):	624,876	827,485
Shpenzime pritje & përcjellje		87,208
Penalitet, gjoba e dëmshpërblime	6,149	135,116
Shpenzime të tjera	618,727	605,161
Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)	25,444,264	14,110,549
 Tatim fitimi @15%	 3,816,640	 2,116,582
	21,002,748	11,166,482

Selcom Shpk
Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(Vlerat janë në Lek)

31. Transaksionet me palët e lidhura.

Balancat me palët e lidhura më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2016</u>	<u>31 Dhjetor 2015</u>
Bilanci kontabël		
Të pagueshme ndaj palët e lidhura:		
S&D Invest	274,602	616,685
Agi Kons	557,339	563,305
Albdesign	2,110,805	2,009,684
Gentian Sula	13,075,951	20,389,139
Altin Bushka	2,132,093	2,223,527
	<u>18,150,790</u>	<u>25,802,340</u>
 Të arkëtueshme nga palët e lidhura:		
BPO Solution	331,653	106,333
S&D Invest Sha	660,943	142,812
Agi Kons	4,723,915	3,978,332
Albdesign Shpk	1,054,938	957,949
	<u>6,771,449</u>	<u>5,185,426</u>

Detajet e transaksioneve me palët e lidhura gjatë vitit të mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>
Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve		
Shitje palëve të lidhura :		
S&D Invest Sha	431,776	114,987
Agi Kons	660,101	418,746
Albdesign Shpk	80,824	236,125
	<u>1,172,701</u>	<u>769,858</u>
 Blerje nga palët e lidhura:		
S&D Invest Sha	174,658	616,684
Agi Kons	414,765	587,672
Albdesign Shpk	658,900	614,456
	<u>1,248,323</u>	<u>1,818,812</u>

Politika e vendosjes së çmimeve për transaksionet me palët e lidhura bëhet në bazë të kushteve të tregut.

24. Angazhime dhe pasiguri

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të kenë efekt negativ në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj.

Më 31 Dhjetor 2016, shoqëria nuk ka angazhime kapitale të kontraktuara por ende të papaguara.

25. Ngjarje pas bilancit

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit që kërkojnë rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.